



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:034453

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697446

KPPP.nr. 206/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, kundër debitorit “Limak Kosovo International” Airport J.S.C, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson SH.S. dhe L.F., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 1066/2023 të datës 21.12.2023, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Irfan I. Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Limak Kosovo International” Airport J.S.C, ndërsa Urdhri Përmbaremore P.nr. 1066/2023 i datës 21.12.2023, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Irfan I. Kërçagu, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në bazë të dokumentit përmbareues - Vendimit Nr. 01/50-09/2023 Gj i datës 02.05.2023 ka caktuar zbatimin e përmbaremit përmes urdhrit përmbaremore P.nr. 1066/2023 të datës 21.12.2023 ndaj debitorit “Limak Kosovo International” J.S.C, të cilin e ka detyruar që në emër të masës ndëshkimore të shqiptuar sipas aktvendimit të lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën e borxhit prej 500.00 EUR (pesëqind euro), në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, nën kërcënimin e përmbaremit me dhunë, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, dhe në shitje të sendeve të luajtshme pronë e debitorit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se e konteston tërësisht urdhrin e lejuar përmbarimor duke theksuar se kërkesa e kreditorit është e pa bazuar, duke qenë se kreditori e ka lëshuar vendimin duke u bazuar në pretendime dhe duke mos marrë parasysh dispozitat procedurale. Pastaj ka shtuar se debitori konsideron se vlerësimi i kreditorit bazuar në ankesat e palëve, është tërësisht jo ligjor dhe tendencioz. Andaj debitori ka konsideruar se urdhri përmbarimor nuk mund të ekzekutohet dhe nuk është i përmbarueshëm, pasi që kushti i përcaktuar në dokumentin përmbarues nuk është i ekzekutueshëm në pajtim me nenin 71 par.1.7 të LPP-së. Krejt kjo duke u bazuar në faktin se debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj Inspektoratit të Punës si dhe ka parashtruar padi në Gjykatë ndaj këtyre vendimeve. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë prapësimin e debitorit, ta abrogojë Urdhrin Përmbarimor P.nr.1066/23 të datës 21.12.2023 dhe ta obligoj kreditorin që t'i bartë shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori në përgjigje në prapësim e ka kontestuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, duke theksuar se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë pasi që dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarimi është i bazuar, i argumentueshëm dhe i ekzekutueshëm. Pastaj ka theksuar se baza juridike për përmbarim, dhe procedura e zhvilluar është në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së, dhe Inspektorët e punës i kanë zbatuar dispozitat ligjore në mënyrë të drejtë si dhe gjendjen faktike e kanë verifikuar në mënyrë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimit të debitorit se ka ushtruar padi në konflikt administrativ, nuk qëndron pasi që padia nuk e ndalë ekzekutimin e vendimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta lërë në fuqi Urdhrin për Përmbarim P.nr.1066/23 të datës 21.12.2023 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Irfan I. Kërçagu.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përbarimor, përkatësisht Vendimin Nr. 01/50-09/2023 Gj të datës 02.05.2023, në bazë të së cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përbarues sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla, dhe i cili vendim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata tutje vlerëson se Vendimi Nr. 01/50-09/2023 i datës 02.05.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri”*, ngase aktvendimi i lartcekur është i pajisur me klauzolën e përbarueshmërisë nga e cila rezulton se i njëjti është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 17.08.2023.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përbarues, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Pretendimet se ndaj vendimit të lartcekur është parashtruar padi në procedurën e konfliktit administrativ gjykata i vlerësoi si të pa ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje përbarimore ngase ushtrimi i padisë në konflikt administrativ nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e vendimit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, kjo në kuptim edhe të dispozitës nga neni 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me të cilin përcaktohet se *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 206/24, datë 16.05.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.